

VENDIM
Nr. 28, datë 23.4.2018

**PËR NJË SHITESË NË “KODI ETIK I KRYETARIT DHE DREJTUESVE TË LARTË
TË KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT”**

Bazuar në nenet 162/1, 163 dhe 164, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 25, pika “a”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI të INTOSAI-t, sidomos në Standardin ISSAI 30 “Kodi i Etikës” dhe në Standardin ISSAI 12 “Vlerat dhe përfitimet e institucioneve supreme të auditimit - të bësh diferencën në jetën e qytetarëve”, me qëllim plotësimin integral të Kodit të Etikës së Kontrollit të Lartë të Shtetit,

VENDOSA:

Në Kodin Etik të Kryetarit dhe Drejtuesve të Lartë të KLSH-së, në nenin 4 shtohet një paragraf me përmbajtjen:

Pas përfundimit të mandatit si Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit, për një periudhë prej 4-mujsh nga data e përfundimit të mandatit, Kryetari që dorëzon detyrën nuk merret me aktivitet aktiv politik.

KRYETARI
Bujar Leskaj